




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH .nr.224/20**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Sib-bka” sh.p.k-Suharekë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prok: 623-20-775-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec, më datën: 24.04.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Sib-bka” sh.p.k-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prok: 623-20-775-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec.

II. **ANULOHET**, njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prok: 623-20-775-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec dhe lenda kthehet ne Ritender.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Sib-bka” sh.p.k-Suharekë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 03.04.2020 me nr. 224/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve te ndryshme" me nr. të prok: 623-20-775-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6 dhe nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 17.04.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se OE ankues Sib-bka, ka ushtruar ankesë në fazën e kritereve për të cilat pretendon se autoriteti kontraktues - Komuna Rahovec ka vendosur kritere në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, përkatësisht nenet 1, 6, 7 te LPP-së.

Sa i përket pretendimit dhe kërkesës së OE ankues i cili kërkon që të hiqet në tërësi kërkesa nr. 1 tek gjendja teknike dhe profesionale ku është kërkuar që: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën e ATK-së të paktën këtë staf profesional (lista e ATK të dëshmoj se stafi profesional është pjesë e kompanisë të paktën nga tre mujori i fundit të vitit 2019 deri më tani). Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar kërkesat mbi teknike dhe profesionale vlerëson se kjo kërkesë e OE ankues është e paqëndrueshme për faktin se pavarësisht kërkesës së lartcekur, autoriteti kontraktues tek dëshmitë dokumentare nr. 5, e ka lënë mundësinë që: "• Staf i profesional (inxhinieret) të cilat nuk janë në listën e kontributeve të dëshmohen me kontratë të punës ose Para-kontrata dhe me Diplomë përkatëse". Prandaj, eksperti shqyrtues duke u bazuar ne sqarimin e dhëne më lartë vlerëson se OE-të e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, në rast se nuk e kanë stafin e lajmëruar në ATK, sipas kërkesës nr. 1, mund të dëshmojnë me para kontrata ose kontrata të punës...,

konform pikës 5 të dëshmisë dokumentare. Lidhur me pretendimin e OE ankues, që ka të bëjë me kërkesën për një inxhinier të ndërtimtarisë - të drejtimit infrastrukture rrugore, për të cilin AK-ja, ka kërkuar një përvoje 7 vjeçare, e që sipas OE ankues me kërkesën për përvoje 7 vjeçare AK-ja e ka kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve në këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se ky drejtim ka filluar në vitin akademik 2012/2013 dhe për rrjedhojë nuk mund të ketë me përvoje siç e ka kërkuar AK-ja. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron me një kërkim të thjeshtë në faqen Universitetit të Prishtinës thuhet se ky drejtim ka filluar në vitin akademik 2012, prandaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm dhe njëherë bie në kundërshtim me nenin 26.4 të RrUOPP-se, për faktin se kërkesa për 7 vite përvoje pune për inxhinierin e ndërtimtarisë - drejtimit infrastrukture rrugore i cili si drejtim është krijuar në vitin 2012 eliminon shume operatore ekonomik dhe sidomos i eliminon operatoret ekonomik të sapokrijuar, për të cilët siç u theksua edhe më lartë është në kundërshtim me nenin 26.4 të RrUOPP-se. Lidhur me pretendimin e OE ankues, i cili kërkon që noterizimi i dokumenteve të hiqet në tërësi si kërkesë me arsyetimin se gjendemi në kohë pandemie dhe sipas OE ankues është me e drejte të hiqet në tërësi. Eksperti shqyrtues, e vlerëson si pjesërisht të drejte kërkesën për faktin se përveç noterizimit si procedure, ka edhe mënyra tjera për të vërtetuar origjinalitetin dhe autenticitetin e dokumenteve. Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me kontratat dhe referencat, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se AK-ja në dosje të tenderit ka kërkuar një numër të madh të projekteve veç e veç, e të cilat janë të njëjta për nga natyra. AK-ja, lidhur me kontratat ka kërkuar:

- 2.1.-Së paku dy projekte të objekteve arsimore-kulturne( shkolla ose qerdhe).
- 2.2. Së paku dy projekte të objekteve sportive (salla sportive ose palestra sportive).
- 2.3 Së paku një projekt të objekteve ekonomike - Tregu i hapur.
- 2.4-Së paku dy projekte të rrugëve me dy korsi qarkullimi, ku së paku njëri nga projektet e rrugëve me dy korsi duhet të jetë me gjatësi të projektit min  $L=7.0$  km.
- 2.5-Së paku një projekt të rrugëve me katër korsi qarkullimi me gjatësi të projektit min  $L=7.0$  km.
- 2.6 -Së paku dy projekte për rregullimin e shtratit të lumenjve, ku së paku njëri nga projektet e lumenjve duhet të jetë me gjatësi të projektit min  $L=7.5$  km.
- 2.7 -Së paku një projekt të ujësjellësit.
- 2.8 -Së paku një projekt të kolektorit të ujërave të zeza, me gjatësi të projektit min.  $L=10$  km
- 2.9 -Së paku një projekt të parqeve ose hapësirave publike me sipërfaqe të projektuar (trajtuar) min  $A=1.5$  ha.

Po ashtu lidhur me kontratat OE ankues ka edhe një pretendim, i cili ka të bëjë me gjatësinë e kërkuar ku AK-ja ka kërkuar, psh: projektim të rrugëve min. 7 km, pastaj projektim të kolektorit të ujërave të zeza min. 10 km, Projektim të parqeve 1.5ha, etj. Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, për

faktin se AK-ja ka kërkuar kontrata veç e veç për projekte qe janë te njëjta për nga natyra e punës dhe fakti qe AK-ja, ka kërkuar kilometra te caktuara dhe hapësira te caktuara e bene edhe me kufizuese pjesëmarrjen e OE-ve ne ketë aktivitet te prokurimit, për faktin se OE-te mund të kenë kontrata te natyrës se njëjte por jo me kilometra te caktuara. Eksperti shqyrtues sqaron se për qene kërkesë me hapur AK-ja, duhet te kërkoje ne lëmi të caktuara, konkretisht me natyrën e projektit siç është infrastrukturë rrugore, ujësjellës, objekte te larta etj. Lidhur me pretendimin e OE ankues, i cili njeherit kërkon qe te hiqet ne tërësi kërkesa ku është obliguar qe ne rast konzorciumi lideri duhet te ketë të paktën: 70 % të stafit profesional. Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë pretendim vlerëson se është i pa qëndrueshëm për faktin se AK-ja, ne ketë rast ka vepruar konform nenit 27.4 te RrUOPP-se, ku thuhet: Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 te LPP-se. Kjo do të thotë se AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësisimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit te OE. Andaj, ne rastin konkrete eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja e ka vendosur ketë kërkesë tek kriteret e gjendjes teknike dhe profesionale. Sa i përket pretendimit te OE ankues se AK-ja te kërkesa lidhur me pajisjet, konkretisht te pika 3.4 ku është kërkuar: Softver për Ura Auto Desk – Struktura BridgeDesigen (Me licence) dhe me ketë kërkesë sipas OE ankues është favorizuar një prodhues i caktuar me arsyetimin se është përmendur emri i prodhuesit. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka përmendur emrin e kompanisë Auto Desk dhe nuk e ka përdorur termin "Ekuivalent" siç parashihet ne dispozitat e ligjit për prokurim publik, andaj, ky pretendim është i qëndrueshëm dhe njëheri obligohet AK-ja, qe te beje përmirësimin e kësaj kërkesë duke ju mundësuar OE-ve te ofertojnë edhe me softëer tjerë. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me larte vlerëson se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e lartpërmendura, prandaj i propozoj panelit shqyrtues qe ta obligoje AK-ne, qe te beje përmirësimet ne kërkesat e sqaruara me larte dhe njeherit te zgjate afatin për dorezimin e ofertave konform nenit 25.7 te RrUOPP-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa njoftimi për kontrate të anulohet dhe të bëhen përmirësimet e dhëna më lartë.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 21.04.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 21.04.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë se autoriteti kontraktues Komuna Rahovecit ka vendosur kritere në kundërshtim me nenin 1, 6, 7 të LPP-së. Më tej OE ankues shton dhe kërkon që të hiqet në tërësi kërkesa nr. 1 tek gjendja teknike dhe profesionale ku është kërkuar që: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën e ATK-së të paktën këtë staf profesional (lista e ATK të dëshmojë se stafi profesional është pjese e kompanisë të paktën nga tre mujori i fundit të viti 2019 deri më tani). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pasi ka analizuar kërkesat mbi teknike dhe profesionale vlerëson se kjo kërkesë e OE ankues është e paqëndrueshme për faktin se pavarësisht kërkesës së lartcekur, autoriteti kontraktues tek dëshmitë dokumentare nr. 5, e ka lënë mundësinë që: "• Staf i profesional (inxhinieret) të cilat nuk janë në listën e kontributeve të dëshmohen me kontratë të punës ose Para-kontrata dhe me Diplomë përkatëse". Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se OE-të e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, në rast se nuk e kanë stafin e lajmëruar në ATK, sipas kërkesës nr. 1, mund të dëshmojnë me para kontrata ose kontrata të punës..., konform pikës 5 të dëshmisë dokumentare.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë që ka të bëjë me kërkesën e AK-së për një inxhinier të ndërtimitarisë - të drejtimit infrastrukture rrugore, për të cilin AK-ja, ka kërkuar një përvojë 7 vjeçare, e që sipas OE ankues me kërkesën për përvojë 7 vjeçare AK-ja e ka kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve në këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se ky drejtim ka filluar në vitin akademik 2012/2013 dhe për rrjedhojë nuk mund të ketë me përvojë siç e ka kërkuar AK-ja. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ka kërkuar në ëeb faqen Universitetit të Prishtinës këtë drejtim ndër tjerat aty thuhet se ky drejtim ka filluar në vitin akademik 2012, prandaj pretendimi i OE ankues është i bazuar. Ndërsa një kërkesë e tillë e AK-së bie në kundërshtim me nenin 26.4 të RrUOPP-së, për faktin se kërkesa për 7 vite përvojë pune për inxhinierin e ndërtimitarisë - drejtimit infrastrukturë rrugore i cili si drejtim është krijuar të vitin 2012 eliminon shume operatorë ekonomik dhe sidomos i eliminon operatorët ekonomik të sapokrijuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k - Suharekë i cili kërkon që noterizimi i dokumenteve të hiqet në tërësi si kërkesë me arsyetimin se gjendemi në kohë pandemie. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson pjesërisht si të bazuar pretendimin e OE ankues për faktin se përveç

noterizimit si procedure, ka edhe mënyra tjera për të vërtetuar origjinalitetin dhe autenticitetin e dokumenteve.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë që ka të bëjë me kontratat dhe referencat. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja në dosje të tenderit ka kërkuar një numër të madh të projekteve veç e veç, e të cilat janë të njëjta për nga natyra. AK-ja, lidhur me kontratat ka kërkuar: 2.1.-Së paku dy projekte të objekteve arsimore-kulturore( shkolla ose qerdhe). 2.2. Së paku dy projekte të objekteve sportive (salla sportive ose palestra sportive). 2.3 Së paku një projekt të objekteve ekonomike - Tregu i hapur. 2.4-Së paku dy projekte të rrugëve me dy korsi qarkullimi, ku së paku njëri nga projektet e rrugëve me dy korsi duhet të jetë me gjatësi të projektit min L=7.0 km. 2.5-Së paku një projekt të rrugëve me katër korsi qarkullimi me gjatësi të projektit min L=7.0 km. 2.6 -Së paku dy projekte për rregullimin e shtratit të lumenjve, ku së paku njëri nga projektet e lumenjve duhet të jetë me gjatësi të projektit min L=7.5 km. 2.7 -Së paku një projekt të ujësjellësit. 2.8 -Së paku një projekt të kolektorit të ujërave të zeza, me gjatësi të projektit min. L=10 km 2.9 -Së paku një projekt të parqeve ose hapësirave publike me sipërfaqe të projektuar (trajtuar) min A=1.5 ha.

Ndërsa lidhur me kontratat OE ankues "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë, ka edhe një pretendim, i cili ka të bëjë me gjatësinë e kërkuar ku AK-ja ka kërkuar, psh: projektim të rrugëve min. 7 km, pastaj projektim të kolektorit të ujërave të zeza min. 10 km, Projektim të parqeve 1.5ha, etj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, për faktin se AK-ja ka kërkuar kontrata veç e veç për projekte që janë të njëjta për nga natyra e punës dhe fakti që AK-ja, ka kërkuar kilometra të caktuara dhe hapësira të caktuara e bënë edhe më kufizuese pjesëmarrjen e OE-ve në këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se OE-të mund të kenë kontrata të natyrës së njëjtë por jo me kilometra të caktuara. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për të qenë kërkesë me hapur AK-ja, duhet të kërkojë në lëmi të caktuara, konkretisht me natyrën e projektit siç është infrastrukturë rrugore, ujësjellës, objekte të larta, etj.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë i cili kërkon që të hiqet në tërësi kërkesa ku është obliguar që në rast konzorciumi lideri duhet të ketë të paktën: 70 % të stafit profesional. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se është i pa bazuar pretendim i OE ankues për faktin se AK-ja, në këtë rast ka vepruar konform nenit 27.4 të RrUOPP-se, ku thuhet: Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. Kjo do të thotë se AK mund

të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit të operatorëve ekonomik. Andaj, AK-ja e ka vendosur këtë kërkesë tek kriteret e gjendjes teknike dhe profesionale.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë se autoriteti kontraktues të kërkesa lidhur me pajisjet, konkretisht të pika 3.4 ku është kërkuar: Softver për Ura Auto Desk – Struktura BridgeDesigen (Me licence) dhe me këtë kërkesë sipas OE ankues është favorizuar një prodhues i caktuar me arsyetimin se është përmendur emri i prodhuesit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja, në dosje të tenderit ka përmendur emrin e kompanisë Auto Desk dhe nuk e ka përdorur termin "Ekuivalent" siç parashihet në dispozitat e ligjit për prokurim publik. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson dhe njëherit obligohet AK-ja, që të beje përmirësimin e kësaj kërkesë duke ju mundësuar OE-ve të ofertojnë edhe me softëer tjerë.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh sqarimet e dhëna si me lart, obligon autoritetin kontraktues që ti përmirësoj/plotësoj kërkesat konform dispozitave të LPP-së, si dhe duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron autoritetit kontraktues që gjatë ritenderimit ti bej përmirësimet të nevojshme në dosje të tenderit konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Rahovec
- 1x1 OE - "Sib-bka" sh.p.k-Suharekë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.